

## Helenët – mund të jenë një nga fiset Iliro- Pellazge

Në historinë e Ballkanit historitë e kombeve dhe të etnive të ndryshme janë mbivendosur në një mënyrë të pabesueshme. Një shtytje më të madhe drejt këtij konfuzioni ngërçlënës etnik ishte pushtimi turk 500 vjeçar, sepse pushtuesit otomanë luajtën rolin e përzjerësit të kazanit të popujve ballkanas aq keq sa që edhe sot është shumë e vështirë të gjesh se ku fillon një popull etnikisht i pastër e ku mbaron tjetri. Megjithatë, filli historik i çdo populli mund të kapet nga historianët profesionistë të mirë qoftë nëpërmjet aftësive individuale qoftë nëpërmjet akademike përkatëse, por si mund të çkokolepset historia e shqiptarëve në kohën kur individë apo akademi e vëndeve fqinjë (përfshi dhe akademinë tonë në ndonjë rast kryesisht nga paaftësia), përpiqen herë pas here të dis-informojnë dhe të keq-interpretojnë historinë e shqiptarëve.

Në këtë shkrim jam përpjekur ‘të ndriçoj errësirën’ që rrethon fisin e helenëve të cilët disa përpiqen t’i japin të kuptojnë qoftë botës akademike e qoftë jo-akademike mesazhe që s’kanë asgjë të përbashkët me iliro-pellazgët, apo me para-ilirët, kurse sipas të dhënave të ndryshme del që helenët mund të jenë një nga fiset iliro-pellazge të hershme në trevat e Ballkanit. Mendoj dhe po përpiqem të dokumentoj se historia e fiseve që banuan në tokat ku sot është Greqia, dhe veçanërisht e helenëve është një histori e fiseve iliro-pellazge.

### i

Dihet që Greqia e sotme nuk ka pasur as emrin Greqi apo Heladhë deri në momentin kur u themelua shteti grek me 1821 i cili hodhi idetë (me ndihmën dhe të historianëve dhe politikanëve anglezë, gjermanë e francezë) se ata ishin pasardhës të grekëve të lashtë.

Greqia është quajtur në kohë të ndryshme të historisë me emra sipas fiseve që jetonin aty sidomos në kohën e paganizmit, por pasi u vendos kristianizmi u quajt si pjesë e perandorisë së Bizantit, por në momente të veçanta historian të ndryshëm para pavarësisë së Greqisë kanë përmendur emra Heladha dhe Helenë.

Aq e vërtetë është kjo sa dhe mbreti Otto (Otton sipas grekëve) i cili u vendos nga Gjermania dhe Anglia si mbret i Greqisë, kur mësoi greqishten vuri re se populli fliste gjuhë tjetër atë shqipe në Athinë dhe u habit shumë nga ky fakt. Dihet gjithashtu se ai u përpoq të realizonte një komb grek solid, qoftë duke zgjeruar tokat e Greqisë, qoftë duke përfshirë kryesisht popullatën arvanitase dhe popullatën greqisht folëse që erdhi nga Azia e vogël, dhe me sllavët e maqedonisë, e me vllahët që jetonin e banonin në atë kohë në ato treva.

Argumenti se nuk kishte një komb grek solid pohohet dhe në një takim në Londër midis një përfaqësuesi të shtetit grek të atëhershëm u përmend dhe fakti se Greqia ‘është një shtet por s’ka komb kurse shqiptarët janë një komb por s’kanë shtet’ (bëhet fjalë për shek 19 pas fitores së pavarësisë së Greqisë).

Që nga rrjedhat më të hershme të historisë së gadishullit ilirik e deri më sot Greqia ashtu sikurse dhe shqiptarët janë quajtur dhe emëruar sipas fiseve të ndryshme që kanë lulëzuar në kohë të ndryshme e në treva të ndryshme brënda Ballkanit dhe Azisë së vogël.

Sipas historisë periudhat ku kanë jetuar fiset në tokat e Greqisë së sotme janë këto:

Europa e Neolitit:  
Periudha Helladike:

*vitet 3000-280 pes*  
*vitet 2800-2100 pes*

Harta e fiseve Ilire dhe te Epirit



(civilizimi egjean, kretan, mikenian)

Greçia e periudhës Mikene:

Greçia e periudhës së errët:

Greçia e lashtë (ose arkaike, ose klasike):

Greçia e periudhës helene:

Greçia e periudhës romake:

Greçia e periudhës romako-bizantine:

Greçia e periudhës otomane:

**vitet 2100-1100 pes**

**vitet 1100-800 pes**

**vitet 800-323 pes** (deri ne vdekjen e Aleksandrit te Madh që nuk ishte grek)

**vitet 323-146 pes** (kur tokat e Greqisë së sotme u pushtuan nga romakët)

**vitet 146 pes – 212 es**

**vitet 330 es -1453es** (viti 330 es, kur Konstandini i madh themeloi Konstandinopojën (Stambollin e sotëm) në një qytet të vogël të quajtur Bizant e deri kur Sulltan Mehmeti i II e pushtoi dhe e quajti Stamboll).

**vitet 1458 -1821(1829)** es (viti 1458 është viti kur u pushtua Athina, e deri kur fitoi pavarësinë Greçia 1821-1829).

Greçia e periudhës moderne:

*vitet 1821 (1829)- e sot, (e deri në 1947 kur u sanksionuan këto kufij që ka Greçia e sotme).*

***Harta e Greqisw sw Lashtw***



Në asnjë rast deri kur Greçia fitoi pavarësinë, asnjë nga banorët e Greqisë së atëhershme nuk njiheshin me fjalën ‘grekë’ por quheshin sipas vëndeve të banimit: athinjotë, thesaliotë, peloponezianë etj.

Sipas fakteve historike fjala Helenë dhe Heladhë u përdor kryesisht nga popilli dhe shteti grek pasi u shpall pavarësia e Greqisë, pra kur dhe historianët e huaj dhe grekë u interesuan për historinë e Greqisë, duke përdorur të gjithë faktet historike të ndodhura në atë territor si histori e Greqisë.

Kjo histori ndahet edhe sipas gjuhës: gjuha e Greqisë së vjetër dhe të re.

Po përpiqem të sqaroj gjithashtu këtu dhe probleme që janë të errta për ne shqiptarët kur jemi përpara historisë së Greqisë për të cilën kanë punuar seriozisht shumë historianë. Problemet po i shtroj nëpërmjet këtyre pyetjeve të cilave:

### **Përse quhej Heladha?**

Grekët janë quajtur me disa lloje emrash nga ta vetë por dhe nga popuj të tjerë. Grekët vetë quheshin helenë dhe toka e tyre ëuhet sipas tyre Helada (Ελλάς).

Homeri quante helenë një tribu e vogël por trime në Phthia të Thesalisë si Helenë, tribu e cila ndoqi pas Akilin në luftën trojane por që shtrihej dhe në Alos, Alope, Trachis, dhe në Pelasgian Argos.

Dihet gjithashtu nga babai i historisë Herodoti I cili thotë se Akili nuk ishte grek por nga fis barbar pra nga fisi i mirmidonëve pra me origjinë iliro-pelazge. Pra dhe helenët ishin një fis iliro-pellazg i cili më vonë predominoi në Greqi mbi fiset e tjera.

Në Antikitetin e thellë grekët vetë quheshin 'rhomanoi' ose 'Romioi', pra romanë, pas vitit 212 es të gjithë grekët e atëhershëm ishin qytetarë romakë. Pas vendosjes së kristianizmit nga Theodhosi i I, termi Helen u përdor për popullatën pagane e cila ndiqte ritet polideiste, pra fenë pagane.

Europeanët e lindjes përdorën termin grekë për grekët, përçifutët përdorën termin 'Yavanim' (Hebre: יָוָנִים), për persianët dhe turqit përdorën termin 'Yunians' (jonianë). Një formë e veçantë u përdor nga gjeorgjianët, ku grekët duheshin 'Berdzeni' (ბერძენი), nga fjala gjeorgjiane 'ëeise'.

Gjatë luftës Trojane në Hellada përshkruhej nga Homer si vendi i grave të bukura ("καλλιγύναικος"). Sipas historianëve Heladha vjen nga fjala helenë por çveshur duke përdorur fjalën laos (λαός) që do të thotë –njerëz. Kryetari i tyre Akili i lutej Zotit Zeus të Dodonës, zotit të Dodonës dhe të Pelasgjisë. Aristoteli përmënd që Heladha e lashtë shtrihej midis Dodona-s dhe lumit Achelous, tokë e pushtuar nga Seloj ( Suljotët-Suli) dhe Grekët. Shihet praprejardhja iliro-pellazge e grekëve që këtu. Shtrirja e kultit të Dodonës dhe të Delfit midis grekëve u rrit shumë duke u shtrirë gjithnjë e më shumë emri i helenëve në të gjithë territorin. ("The Greeks". *Encyclopedia Britannica*. US: Encyclopedia Britannica Inc.. 2008. Online Edition).

Emri Hellas, që mund të lexojmë nëpër tekste për Greqinë, nuk ka qënë asnjëherë emri që i jepnin Greqisë as autoktonët dhe as romakët. Në fakt, ajo nisi të quhej zyrtarisht nga të gjithë Hellas, shumë më vonë, atëhere kur u krijua mbretëria e pavarur në vitin 1830 të epokës sonë. Më parë, dhe veçanërisht gjatë perandorisë bizantine, ajo kurrë nuk është quajtur Hellas e as Graecia, as perandori greke apo helenike, por gjithnjë Perandori e Bizantit. Perandori bizantin asnjëherë nuk është cilësuar helen apo grek.

Janë shkrimtarët moderne që iu kanë atribuar popullatës së vjetër greke fjalët helenik apo grek, por kurrë nuk janë përdorur nga populli. Në atë kohë ende nuk kishte një bashkim kombëtar, por veçse rivalitete mes qyteteve-shtete kryesore si Sparta, Athina, Teba, etj. (Robert D'ANGELY 'Enigma').



**Piktura: Akili, Mbreti i Thesalisë dhe i Mirmidonwve, duke tërhequr zvarrë Hektorin**

Një variant tjetër është kjo: Dhe me sa duket dhe vete termi ELADHA (Ελλάδα, Elláda, e' llada) është sinonimi i fjalës GRAIKIA, që ishte vendi i grave të bukura; ose e përkthyer prapë në shqip (iliro-pellazgjisht): Eladha – e la dhenë. Vetë fjala 'graikia' ka kuptim shqip dqë do të thotë 'gra' në kuptimin e grave të bukura.

Historiani i lashtë grek Tuqididi, duke folur për Helladen, thotë se ajo nuk ekzistonte me parë dhe se "emrin asaj ia dhane, sipas emrave të tyre, fiset e ndryshme, me tepër pellazget".

Sipas mitologjisë Herodoti, vep. II 49 shkroi: "Bredhja e Kadmit (birit të mbretit fenikas, Agenorit e Telefasës) i cili është konsideruar si themeluesi i Thebës në Beotii dhe që solli në Helladë kultin e Dionisit nga Egjipti, Kadmi ishte duke kërkuar motrën e vet të humbur Europën, me urdhërin e babait të tij Agenorit. Kadmi u bë mbret i fisit illir Henhellej (Enhellej)- Hellada." (ILLIRISTIKA - nga albanologu prof. Nezir Myrta (Drillon Gega) [Nezir.Myrta@shqiperia.com](mailto:Nezir.Myrta@shqiperia.com)) por kjo është pak e dyshimtë sipas meje.

Aristidh Kola (sipas Vasil Dh. Zeno)- emrat "Ellas" (Greqi), Elinas (Grek) konstaton se "Grek" dhe "Greqi" paraqiten si emër i përbashkët i të gjithë banorëve të mjediseve greke dhe të vendit, gjatë zbritjes së dorëve, pasi u qetësua gjendja dhe u vendosën qetësia, dhe lidhjet midis gjithë fiseve greke. Ellas përmendet tek Homeri si një vend i vogël afër maleve të Pindit, ku karakteristika më e rëndësishme ishin gratë e bukura ("Elladha kalogjineka" e quan Homeri), dhe prijës i saj ishte më i lavdishmi hero i grekëve, Akili.

Egziston një Mit (sipas Tukididit) që vazhdon të flasë për Defkalionin, i cili, pas përmytjes së njohur biblike, u bë me dy fëmijë: Elinin (Heleni) dhe Amfktionin.

Ne kohën e zhvillimit Aheik, greket përbëheshin nga të pakten shtate fise dhe shtete. Nga lumi **Pinios** deri tek lumi **Sperhios** quheshin **Elines** dhe vendi i tyre **Ellas apo Elladha**, atë vend që pellazget me përpara e quanin **Fthia** dhe doriket me pas **Thessalia**. Kryeqytet i këtij shteti i shtë **Iolkos** që rinte dhe prijësi Aheik (Pellazgët, Formumi Shqiptar-2005).

Sipas "The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present" (pra "Shqiptaret. Një Histori Etnike që në Kohën e Lashtë e Deri Sot" nga Edëen E. Jacques) duke u mbështetur tek shkrimtarë të lashtësisë si Herodoti, Strabo, Dionisi, Plini i Vjetri, Hesiodi, Homeri, Sofokliu, Euripidi, Virgjili dhe shumë të tjerë që kanë shkruar mbi Pellazgët thotë se, Pellazgët ishin paraprindë të Ilirëve të cilët nga ana e tyre u paraprindë Shqiptarëve. Shkrimtari pohon se, sipas shkrimtarëve të antikitetit, Pellazgët shtriheshin në të gjithë gadishullin e Ballkanit dhe bregdetin Egje, madje deri në brigjet e Detit Egje në Azinë e Vogël duke përfshirë Trojen. Ata dhe gjuha e tyre konsideroheshin "barbare" term që u jepej popujve jo-helene të antikitetit. Ai i bëri një analizë Iliadës kryesisht të Homerit, në të cilën del qartë se të gjithë personazhet si mbrojtësit dhe sulmuesit e Trojes janë Pellazgë. Dmth si Akili dhe Hektori janë Pellazgë të fiseve të ndryshme që shpesh grindeshin për gjëra nga më të voglat në këtë rast për një grua po Pellazgë, Helenën. (Kjo grindje ndër-fisnore tek shqiptarët ka vazhduar e trashëguar me mijëvjeçare që nga lashtësia, mesjeta gjatë së cilës e dime çfarë hoqi Skenderbeu të bashkonte fiset aristokrate shqiptare të kohës dhe ruhet akoma edhe sot nëpërmjet "hakmarrjes" apo "grindjeve të gjakut") Homeri në veprën e tij përmend Akejtë, Argivitet dhe Dananet (Achaean, Argivites dhe Danaans) por në asnjë rresht të kësaj vepre nuk përmend Aeolianet, Ionianet apo Doret që janë edhe fiset që themeluan qyteterimin Helen apo Grek siç njihet ndryshe. Për të parët autori thotë se, Homeri i ka identifikuar qartë si fise Pellazgë, por gjithashtu shprehet se, shumë historianë të sotëm i identifikojnë një me Grekët që për autorin përben një gabim shumë të madh. Ai madje shprehet: "Sigurisht, historianët e lashtësisë dinin ta bënin këtë dallim."



*Heleni, biri i Dukalionit dhe Pyrrha-s sipas variantit grek (skulptura)*

Sipas folklorit të tyre, Greket i kanë rrënjët më vonë rreth vitit 800 p.e.s në martesën e Deucalion me gruan e tij Phyrë nga bashkimi i të cilëve lindi djali i tyre Heleni i cili me vonë i dha emrin shtetit Hellas dhe pasardhësve të tij Helenet. Kjo mund të shpjegojë dhe arsyen pse Homeri nuk i ze në gojë Hellenet ose edhe fiset e vecanta të tyre gjatë luftës së Trojes. Kjo luftë zhvillohej shumë më herët rreth viteve 1250 p.e.s. Edhe nga historia dyndjet e fiseve greke, p.sh. doreve fillojnë rreth viteve 1200 p.e.s në mënyrë sporadike dhe vetëm rreth viteve 1100 p.e.s ato vendosen përfundimisht në disa qytete në territorin e Greqisë së sotme duke bashkjetuar me shtresën Pellasge që pushtuan të cilët me vonë do të asimiloheshin në një mënyrë ose në një tjetër. Duhet sqaruar se fiset greke ishin popuj Indo-Europianë që depertuan në veri dhe pastaj zbritën nga stepat e Rusisë. ("The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present", Edhe E. Jacques).

Emri Hellas, që mund të lexojmë nëpër tekste për Greqinë, nuk ka qënë asnjëherë emri që i jepnin Greqisë as autoktonët dhe as romakët. Në fakt, ajo nisi të quhej zyrtarisht nga të gjithë Hellas, shumë më vonë, atëherë kur u krijua mbretëria e pavarur në vitin 1830 të epokës sonë. Më parë, dhe veçanërisht gjatë perandorisë bizantine, ajo kurrë nuk është quajtur Hellas e as Graecia, as perandori greke apo helenike, por gjithnjë Perandori e Bizantit. Perandori bizantin asnjëherë nuk është cilësuar helen apo grek. Janë shkrimtarët moderne që iu kanë atribuar popullatës së vjetër greke fjalët helenik apo grek, por kurrë nuk janë përdorur nga populli. Në atë kohë ende nuk kishte një bashkim kombëtar, por veçse rivalitete mes qyteteve-shtete kryesore si Sparta, Athina, Teba, etj.



**Neoptolemi, biri i Aklit vret Priamin**

Duke u nisur nga kjo periudhë helenistike, veçanërisht nga pushtimi i Greqisë prej romakëve, qendra e helenizmit nuk ishte më Athina apo qytetet e tjera të Greqisë, por Azia e Vogël dhe Egjipti. Ky regjim i shpërndau helenët dhe kjo solli ç'popullimin dhe varfërimin e Helladës, të cilën Plutarku e përshkruan në epokën e tij si një vend pothuaj të shkretët, dhe ishte ky shkaku i formimit të një Greqie të re e të madhe, të pasur dhe të dëndur në Azinë e Vogël, si dhe të një qendre të kulturës helenistike tepër të lulëzuar dhe të begatë në Aleksandri. Kjo nuk ndodhi shumë shpejt. Përballë përhapjes dhe zgjerimit të kristianizmit, i cili ishte bërë tashmë një besim i shtetit, talente të mëdha do të pikasin në gjirin e dhiakërve dhe të priftërinjve të edukimit helenik, një lidhje e vërtetë kjo midis kristianizmit dhe helenizmit të vjetër. Nga kjo kohë dëshmohet një zhvillim i vërtetë letrar mjaft i rëndësishëm, por për një kohë të shkurtër, pasi më pas në shekullin tjetër u shfaq një „bizantinizëm“ i vërtetë me të gjitha intrigat dhe sterilitetin

letrar. Kështu helenizmi do të venitet nga dita në ditë duke u zëvendësuar nga një kristianizëm asketik dhe grindavec. Shtrirja e ngadalte e saj nuk të lejon të fiksosh një datë të zhdukjes së saj, pasi kjo ka ndodhur ngadalë. Në fakt helenizmi mori fund atëhere kur nuk pati më vepra madhore. Këto vepra, që ishin ende të shumta në shekullin e V, bëhen më të rralla e më mediokre, në shekullin e VI. Ato mbarojnë më së fundi rreth mesit të shekullit të VII. “Në sajë të filologjisë, helenizmi që ishte në rënie, u lidh me helenizmin e shekujve të mëdhenj klasikë, pasi ajo lidhet me veprat e mëdha të së kaluarës për t’i interpretuar, komentuar dhe gjykuar “.

### **Përse Helenët?**

Sipas English Wikipedia, fjala Helenë në kuptim më të gjërë është përdorur për herë të parë në një mbishkrim nga Echembrotus që i dedikohet Herakliut për fitoren e tij në lojrat Amfiktionike dhe i referohet Olimpiadës së 48 (viti 584pes).

Sipas legjendës më të pranuar Heleni i biri i Deukalionit dhe Pyrrha, u martua me nimfën Orseis dhe pati tre fëmijë Aeolus, Doris, Xuthus, me të cilët themeloi tributë e Heladhës Aeolianët, Dorianët, Acheanët dhe Jonianët (varianti grek).

Shën Palin në letrat e tij në testamentin e ri përdor fjalën helenë pothuajse gjithmonë sit ë kundërt të hebrenjve, dhe për të çpërfillur etnitë e tjera (romanët, sirianët, egjiptianët, etj) që jetonin në ato zona në atë kohë.

Përdorimi laik i fjalës Helenë u ringjall në shekullin e IX es, pasi paganizmi u eklipsua nga kristianizmi dhe nuk përbënte më kërcënim për kristianizmin i cili tashmë dominonte.

Kur interesi për grekët u rrit, historianët englezë preferonin të përdornin termin Romanë (Edward Gibbon), ndërsa historianët francezë preferonin ti quanin grekë (ndoshta nga Pukëvili i cili përdori zhargonin e Ali Pashë Tepelenës i cili i quante jo-shqiptarët grekë).

Termi Helenë i riçfaq në shek XIX es dhe dominoi në historiografi, biles në Greqi megjithë kundërshtimet e Constantine Papparegopoulos (përfaqësuesi me influencë i Gibbonit në Greqi) kjo perandori i quajti Greke. Pak shkollarë grekë e adaptuan këtë fjalë, por kjo u bë popullorë në gjysmën e dytë të shek XX es. Emri më popullor për grekët në Greqi ishte emir romanë (Ρωμαίος) biles edhe pas formimit të shtetit grek më 1829. Sipas Argyris Eftaliotis që publikoi një histori të Greqisë më 1901 me titullin ‘Historia e Romanëve’, në të cilën fliste për trashëgiminë romake të grekëve deri vonë në shek e XX.



**Kapja e Andromakës gruas së Hektorit, nga Neoptolemi, djali i Akilit**



Termi helen, sidomos në fillimet e veta, nuk përcaktonte një komb. Mund të bëheshe grek apo helen vetëm duke mësuar apo folur gjuhën e vjetër greke. Helenët nuk formonin një grup popujsh siç ishin jonianët, eolianët, dorianët, por një grup i dalë nga elementi pellazgjik primitiv, i mpleksur me të huajt, si me fenikasit, egjiptianët...(pra me pushtuesit fitimtarë). Emri helen ka filluar të përhapet në Greqi si dhe në ishujt përreth, në Greqinë e Madhe dhe në Azinë e Vogël, që nga shekulli VIII p.e.s. (Smith, Anthony D. (1999). *Myths and memories of the nation*. Oxford University Press. p. 21. ISBN 0-19-829534-0. "It emphasizes the role of myths, memories and symbols of ethnic chosenness, trauma, and the 'golden age' of saints, sages, and heroes in the rise of modern nationalism among the Jews, Armenians, and Greeks—the archetypal diaspora people").

### **Përse quhen me emrin Grekë dhe Greqi?**

Siç u tha dhe më lart në anglishten modern fjala Grek rrjedh nga latinishtes – Graecus e cila e ka origjinën nga fjala Graikos (Γραικός)- grek, (por që në shqip ka kuptimin –gra, grua). Është një eponym i grekëve të Eubesë që migruan në itali në shek 8 pes. Këtë fjalë 'Graea' e përdor Homeri tek Iliada për disa luftëtarë që morën pjesë në luftën e Trojës e që erdhën nga një vend që ëuhej Graea, por edhe sot askush nuk e di se ku është ky vend. Aristoteli thotë që ky vend ndodhet pranë Oropus në lindje të Delion. Këta njerëz ranë në kontakt me romanët të cilët i quajtën grekë 'graeci'. Aristoteli e përmend fjalën graecoi për banorët e një vendi në Epir në të cilën pati një rrëshqitje dhe në atë kohë.

Sipas Hesiodit kjo fjale 'Graecus' është e Deucalionid-it dhe vjen nga fjala geranius- ose grua plakë e cila fjalë u jepej si titull priftëreshave të Dodonës.

Pasi u krijua shteti i pavarur grek qytetarët grekë e quajtën vehten helenë duke bërë lidhjen me Greqinë e lashtë. Kjo ide nxiti një passion të fiksuar mbi antikitetin në Greqinë e pavarur tashmë duke lënë pas dore dhe nënvlerësuar historinë e Perandorisë së Bizantit sepse në atë kohë mbanin emra të ndryshëm në kohë të ndryshme.

Historianët klasikë europianë u prirën që të përkrahnin idenë greke apo Megali idea greke të cilët kërkonin të përtërinin Konstandinopojën dhe Perandorinë e Bizantit si vënd për të gjithë grekët. Ndërsa ministri i punëve të jashtme të Greqisë foli para parlamentit grek më 1844 kështu: 'Mbretëria e Greqisë nuk është Greqi; kjo është vetëm pjesë e vogël e varfër e Greqisë. Ka dy qëndra të mëdha të helenizmit. Athina është kryeqyteti i mbretërisë. Konstandinopoja është kryeqyteti i madh, qyteti i ëndrës dhe i shpresës për të gjithë grekët' (Markezines, "Political History of Modern Greece", book A, pp.208, Athens.).

### **Gjuha Greke dhe ajo Iliro-pellazge**


Gjuha greke e vjetër nuk mund të plotësohet më së miri pa prekur dhe gjuhën iliro-pellazgike të vjetër pasardhësja e së cilës është pa dyshim shqipja me të cilën mund të përkthehen gjithnjë e më tepër fjalë e fraza, qoftë në greqishtene vjetër qoftë në gjuhët e vjetra të vdekura.

*Gërmat e vjetra greke që nuk përdoren sot të ardhura nga fenikasit; ngelur nw pwrdorim deri nw shek V es.*

ƆƆ [Digamma](#) ƆƆ [Qoppa](#) Mm [San](#) ƆƆ [Sampi](#)

*Gwrma tw tjera qw janw pwrdorur nw greqishten e lashtë*

ƆƆ [Stigma](#) Pp [Sho](#) F+ [Heta](#)



*fjalë greke – στρατόν - (kjo fjala këtu është e shkruar në greqishten e re) shkruar me lidhje sigma-tau në njëdorëshkrim bizantin . vëreni dallimin.*

Ndryshe nga emrat pellazg apo në shqip leleg (siç quheshin pellazgët nga fenikasit për shkak të veshjes së tyre të bardhë që mbanin deri në shekullin e VI p.e.s.), të cilët ishin përhapur prej shumë e shumë kohësh, N.Ceka përmend se ‘shkenca arkeologjike shënon se nga mesi i mijëvjeçarit IV deri rreth viteve 2600 ka ekzistuar një qyteterim neolitik i një popullsie që greket e quajten me emrin "Pellazg", që duket se kishin dicka të vecante në pamjen fizike, në mënyrën e folurit në "s" të zgjatur (Lissos, Issa, Larissa etj.) (Neritan Ceka, "Iliret", T 2000, f.33).

Sipas Sami Farshërit, ”Më të vjetrit e prindërve tanë bota i quan pellazgë, fjalë e mbetur nga prindërit tanë më të pastajmë, të cilët quajnë më të parët e tyre Plak e Pleq”, Sami Frashëri “Shqipëria çka qenë, ç’është e çdo të bëhet”.

Emri i pellazgëve mbetet "një emërtim përgjithësues", duke qenë i përshkruar si popull i lashtë parahistorik, i quajtur emërtim përgjithësues" dhe duke qenë i përshkruar si popull i lashtë parahistorik i quajtur "shpellagji", që do të thotë njerëzit e guvave. Egjiptianët i quanin "pelesët" dhe hebrenjtë "peleshtim". Këto etnonimi na kujtojnë filistinët (pellesh...et, peleshetâ€|im, domethënë "shpellagji"), që nuk është gjë tjetër veçse emri që u është dhënë prej semito-egjiptianëve (Mathieu Aref, "Shqipëria, odiseja e pabesueshme e një populli parahelen").

Faktet thonë se gjuha pellazgjishtë nuk është e shkruar por dhe gjuha greke e vjetër është shkruar vetëm nga fundi i shekullit VII. para Krishtit.

Sipas Wikipedia gjuha greke ka qenë shkruar në një alfabet të veçantë grek afërsisht nga shek i IX pes. Është krijuar nga modifikimi I alfabetit fenikas duke shtuar këtij alfabeti zanoret dhe duke krijuar disa bashkëtingëllore të veçanta. Ky variant alfabeti përdoret dhe sot veçanërisht variant I alfabetit jonik të përfshirë në alfabetin klasik të Atikës në vitin 403 pes.

Gjuha greke ka këto periudha.

- **Proto-greke**
  - **Mykeniane** 1600-1100 pes
  - **Greqishtja e lashtë** 800-330 pes me dialektet: [Aeolic](#), [Arcadocypriot](#), [Attic-Ionic](#), [Doric](#), [Locrian](#), [Pamphylian](#); [Homeric Greek](#), ka mundësi dhe [Macedonian](#).
  - **Greke Koine** (forma popullore e të folurit) 330 pes-330 es.
  - **Greke mesjetare** 330 es – 1453 es
  - **Greke moderne** nga 1453 es –e sot
- (sipas english Wikipedia: greek language –korrik 2010)

Gjithnjë duke iu referuar shkrimtarëve grekë të Antikitetit, gërmat e para që u shpikën ishin pellazgjike, të cilat fillimthi lindën në Egjipt e pastaj u shpërndanë më gjërë, së pari rreth Mesdheut e më tej, nga ku më pas, alfabeti fenician u soll në Tebë nga Kadmi, ç’ka bëri që gërmat të quhen kadmiane. Autori shton se nëqoftëse çifutët shpikën pikë-zanoret, ishin në fakt pellazgët ata që patën nderin të krijojnë zanoret. Nga ky alfabet pellazgo-fenician, dolën gjuhët helene, etruske dhe latine, të cilat janë kryesoret, dhe ku duhen shtuar dhe gjuhët pellazgo-tireniane, eteokretase, kadmiane, dhe gjuhët e tjera të Greqisë ai ajo hitite, lisiane, lidiane, qipriote dhe gjuhët e tjera të Azisë së Vogël si ombriane, oske, sabelike dhe gjuhë të tjera në Itali, pa harruar alfabetet e ndryshme neo-latine, të cilat relativisht janë më të vona (Robert D’ANGELY ‘Enigma’).



Pelazgus (disa e quajnë dhe Dardani) sipas mitologjisw ishte biri i Poseidoni dhe i Larissa, themeluesi i Argosit Thesalian

Mathieu Aref thotë (marrë nga gazeta Shqip/Shqiptarët, a janë populli më i vjetër...? Thursday, May 03, 2007):  
 “Turqididi .. në librin e tij të parë kapitulli III, ka kapërcyer katër shekuj. Këta janë 4 shekujt e errët, për të cilët nuk kemi thujse asgjë përveç linearit B. Lineari B është deshifruar nga Shadiuk dhe ata kanë plotësisht të drejtë qëkur e kanë quajtur greqishte të vjetër. Por nuk u kuptua që kjo greqishte e vjetër, në fakt, ishte pellazgjishtja e vjetër. Herodotin e kanë trajtuar si barbarofil, sepse foli për pellazgët si popullsi parahelene. Me të drejtë ka pohuar që pellazgët u dhanë grekëve një pjesë të gjuhës dhe mitologjinë. Por si mund të hidhet poshtë kjo që ka thënë babai i historisë, të tjerë e deri te Turqididi? Unë mbështetem te të vjetrit dhe jo te të rinjtë që kanë thënë gjithçka pa kundërshti”.

Gjuha e lashtë greke, nga ana e fjalorit si dhe nga ana e sintaksës dhe morfologjise gjendet me afer me greqishten e sotme sesa italishtja me latinishten. Gjuha greke nga fakti se është dokumentuar shume heret Mikenasit dhe ka qene e shkruar, por problemi eshte se gjuha mikenase ishte e shkruar ne kohen qe herodoti thoshte se greqia banohej nga pellazget e se dialektet eole dhe jonike u shkeputen nga pellazgjishtja. Ne kete kuptim greqishtja permban te njejtin fond morfologjik dhe te fjalorit qe nga koha e Homerit deri me sot.

Disa fjale te gjuhes greke mikenase jane: **αναξ** (mbret, sot **ανακτορο**), βασιλευς (sot βασιλιας) etj. Vetem se basileus ne periudhen mikenase nuk ishte mbret,se mbreti quhej vanas,kurse basile ose pasile vinte pas mbretit si nje prej dinjitareve apo pjese e administrates.

Fjalor etimologjik i greqishtes se lashte me krahasime me gjuhet e tjera indoevropiane është ai i Hofman (J. B. Hofmann, (EËG), 1950).



*Shtrirja e pellazgëve apo të proto ilirëve*

**Greqishtja e lashtë** është gjuha Shqipe e shkruar në antikitet dhe greqishtja e vjetër nuk ka aspak të bëjë me greqishten e re sepse greqishtja e re është një gjuhë semite e cila ka rrenjet në gadishullin arabik dhe greqishtja e vjetër është vetëm dhe vetëm Shqipja e shkruar dhe për herë të parë është shkruar me 600 para erës sonë dhe Shqipja është shkruar edhe me para qysh para 3500 vitesh dhe është gjuha e cila ka lindur gjuhët indoevropiane dhe latinishtja është përfundimisht Shqip. Shkrimi dhe gramatika e greqishtes së lashtë është zhvilluar vazhdimisht dhe disa pika të theksuara të këtij zhvillimi nga gjuhëtarët e shkolluar janë klasifikuar dhe për qëllime studimore edhe janë emërtuar. Këto emërtime zakonisht janë bërë duke i shtuar emrit të greqishtes si mbijemra emrat e fisit, dijetarëve, hapësirave, etj. që kanë marrë frymën e zhvillimit të gjuhës apo sundimit në hapësirën e Ballkanit perëndimorë. Kështu që studiuesit, me *Greqishten e lashtë* kuptojnë gjuhën apo variantet e saj të shkruara, si gjuhë e qytetërimit të atëhershëm të popullit të Ballkanit perëndimorë në trojet e Greqisë së sotshme dhe më gjerë. Po ashtu një variant gjithëpërfshirës i greqishtes së lashtë ishte edhe gjuhë e dytë në një pjesë të madhe të Perandorisë Romake dhe është gjuhë zyrtare e disa kishave të sotshme ortodokse. Kjo gjuhë studiohet në shkollat e universiteteve në mbarë botën që nga koha e Rilindjes. Edhe greqishtja e lashtë sikurse latinishtja hynë në grupin e gjuhëve të vdekura. Atë e gjejmë në drejtime të ndryshme shkencore ekzakte dhe shoqërore.

(<http://ëëë.ansëers.com/topic/greek-language>, <http://ëëë.communicaid.com/language-courses/greek/index.php>,  
<http://ëëë.toplanguagecommunity.com/greek-portal/>, <http://ëëë.eslbase.com/language-exchange/greek>,  
[http://simple.ëikipedia.org/ëiki/Greek\\_language](http://simple.ëikipedia.org/ëiki/Greek_language), <http://ëëë.studyabroad.com/lom/greek.html>  
[http://ëapedia.mobi/en/Greek\\_language](http://ëapedia.mobi/en/Greek_language)).

Ja ç'kendonin Pellazgët ne kohen e Pal Kunduriotit.(nga nje fragment me i gjate)


"Ashtu dhe ti moj Plak' e Athenës së vërtetë  
Gjëri Pelasgor' e vjetër, mburru se ke t'drejtë;  
Prapë dot munç të brohoriç si e ke zakonë  
Hire burrash Pelasgësh, si bëje gjithë monë"  
Marrë nga Forumi shqiptar

(Marrë nga Forummi shqiptar: Arcas 10/11/2005).

Sipas studiuesit Clirim Xhunga ‘‘Shpjegimi i prejardhjes së fondit të leksikut të greqishtes së vjetër mund të bëhet vetëm me anë të gjuhës shqipe. Greqishtja është një gjuhë e ndërtuar në katedra gramaticienësh. Ky pohim s’është i ri. Këtë e konfirmojnë si Haustrate, ashtu edhe D’Agnely, ndonse unë nuk kam gjetur tek asnjeri prej tyre dëshmi gjuhësore bindëse. Por studimi ynë mbi greqishten e vjetër na tregon se këta dijetarë kanë patur prova të pakundërshtueshme për të shtruar këtë hipotezë, por kushtet nuk i kanë lejuar ta shtjellojnë atë. Greqishtja e vjetër jo vetëm që është një sajesë, një gjuhë e sajuar nga njerëz që flitnin një gjuhë tjetër, por ajo ngërthen në vetvete një mori problemesh të karakterit gjuhësor. Kështu p.sh. shkallët e krahasimit të mbiemrat në greqisht ndërtohen me prapashtesën – τερος {τερ = i tërë + ος = është} në shkallën krahasore dhe me –τατος {ταυ = të tan, të tërë + τος} në shkallën sipërore. Edhe leksiku i greqishtes së vjetër mbahet në këmbë nga rrënjë të shqipes. Në greqishten homerike rrënja e shqipes shfaqet e diversifikuar si në shqiptim dhe në të shkruar. Kjo ka ndodhur në rradhë të parë sepse fjala shqipe ka kaluar nga njëri dialekt grek në tjetrin, duke pësuar ndryshime fonetike, dhe semantike sa që tek Iliada dhe Odisea ne gjejmë një mori fjalë që vërtiten rreth një rrënjë të vetme. Kështu krahas Re kemi Ra, krahas Er kemi Hr dhe Ir, krahas Pei kemi Fei, në krahë të Pa gjejmë Fa. Po kështu kemi Men, Man dhe Mhn, Damo dhe Dhmo, Xeir dhe Keir, Pur dhe Pir, Kar dhe Khr. greqishtja e vjetër ashtu edhe latinishtja s’janë gjë tjetër vecse vazhdimet të deformatuara të shqipes në dy alfabetet e ndryshme. P.sh, τοκεύς { τοκε\* tokë + ύς\*} ai që krijon, ati (celui qui engendre, père) ; ἡ τοκεύς, ESKILI nëna (la mère). Në sh. dhe duel : prindërit (parents). Krahas. formimin e fjalës τοκεύς me Ζεύς, Zeus {zë ish}’’(pjesë shkrimi të botuar te gazeta Koha Jonë më 31 mars dhe 1 prill 2005).

Vicens Dorsa (studiues arbëresh) shkruan se në shqipe ruhen rrënjët e dialektit (digamës) eolik parahomerik.

N. P. Elefteridhi pohon se greqishtja në pjesën më të madhe u formua gati e tëra nga gjuha pellasgjike.



Këto mbishkrime tëpvogla janë gjetur në ishullin Lemnos të cilat provojnë se Pelazgët jetonin nëkomunitetet e tyre te izoluar që në shek 7-6 pes. Hesiodi, Homeri dhe autorë të tjerë grekë na japin ne që padyshim shënjat e Lemnos-itjanë gjuhë pelazgike. Shenim . janë të ngjashme me gërmat greke.

Jakov Thomopullo dëshmon se ka lexuar mbishkrimet eteo-krete nëpërmjet gjuhës shqipe. Robert d'Angely shkruan: "...Shqiptarët janë më të vjetër se grekët, kjo s'ka dyshim, tingulli monosilabik është provë për këtë. Origjina e shqipes dhe e greqishtes nxjerr në pah në mënyrë të padiskutueshme raportin e vërtetë mes tyre, atë të prejardhjes së greqishtes nga gjuha shqipe: nëna e saj".(R.D'Angely-Enigma).

Sipas Robert D'Angely, thuhet: 'Në vitin 146 p.e.s. ndodhi pushtimi i Greqisë nga romakët që quheshin Akaie. Gjuha e popullit ishte gjuha pellazgo-shqiptare, ndërsa gjuha zyrtare, latinishtja. Pas vitit 800 dhe veçanërisht pas skizmës së parë në vitin 860, datë kur fillon Perandoria bizantine (emër që iu dha Perandorisë romake të Lindjes kur ajo u nda nga Perandoria romake e Perëndimit), përdorimi i latinishtes zyrtare fillon të pakësohet në përpjestim me greqishten që është tashmë gjuhë e kishës së Lindjes. Popullsitë shqiptare të Perandorisë bizantine që ishin të fesë kristiane ortodokse të Lindjes u quajtën Γρακοί apo Ρωμαῖοι dhe Ρωμαῖοι, por ata mësonin gjithnjë vetëm në greqisht, që ishte gjuha e dytë, pas asaj shqiptare. Ky evolucion i ngadaltë e bëri Bizantin një perandori me popullsi shqiptare dhe qytetërim helenik, me gjuhë zyrtare greqishten e vjetër. Atëhere populli, i cili si gjithnjë nuk e dinte latinishten dhe nuk e fliste atë. Po kështu ai nuk fliste njëkohësisht as greqishten e vjetër dhe së fundi as atë moderne, që ende nuk kishte lindur. Për popullin romako-bizantin, të dy gjuhët, latine e greke, ishin të panjohura'. (Robert d'Angely 'Enigma ' -vëllimi i I, Pellazgët, 1990, f. 5-140).

Për më tepër, për autorin, greqishtja e Iliadës është akoma më e vjetër, pra më arkaike se ajo e Odisesë. Iliada është e mbushur me fjalë pellazgjike, me sufikse dhe prefikse greke. Odisea u shkrua dhe u përkthye shumë kohë pas Iliadës, dhe u desh jo më pak se 150 vjet për të arritur greqishten e Odisesë.“ (Robert d'Angely ‘Enigma ‘ –po aty, 1990, f. 5-140).

Përsa i përket origjinës së pellazgëve unë mbështes teorinë e Aristidh Kolës përsa i përket që pellazgët dhe ilirët si dhe helenët (grekët) si pjesë e tyre nuk janë popullsi indo-europiane por autoktone evropiane, porka një teori krejt tjetër (që unë e mbështes por që nuk e ka parë ndonjë historian) e ardhur nga Testamenti i Vjetër i cili thotë se: - Pellazgu (apo siç e thotë një historian –Dardani) është stërnipi i Shem-it një nga djemtë e Noa-s me emrin Pelegu. Shemi (stërgjyshi i hebrejve dhe djali i Noa-s së përmytjes së madhe) kishte 5 djem dhe Arami biri i tij lindi Arpakshdin,-ky lindi Shelahun,-ky lindi Everin dhe ky lindi Pelegun. Ata u shpërndanë nëpër trojë të ndryshme. Njëri nga ata Pelegu shkoi në gadishullin Ilirik dhe u dha emrin pellazgëve. Prandaj ndoshta nuk përkthehet në shqip siç janë munduar ta përkthejnë shumë historianë pro pellazgë dhe anti pellazgë

(Testamenti i Vjetër- Libri i Zanafillës-‘Pasardhësit e bijve të Noah-ut-10-d-25. F.15).

## ii

Egziston dhe një konfirmim tjetër të cilin unë po e kujtoj në këtë shkrim përsa i përket origjinës iliro-pellazge të hellenëve si dhe ndërthurjen e natyrshme dhe aspak armiqsore të citimive historike.

Sipas Myth&Legends të shkruar nga Thomas Bullfinch, 1993, Helenus-I (‘Ελενος) ishte i biri i Mbretit Priam dhe mbretëreshës Hekuba dhe vëllai binjak i profeteshës Kasandra. Helenusi quhej gjithashtu dhe Scamandrios. Sipas legjendës Kasandra spjegonte profecitë por Apolloni ja kishte hequr asaj forcën bindëse, po kështu ishte dhe Heleni (Helenus-i). Në luftën trojane mori pjesë I udhëequr nga vëllai I tij Hektori (Priami kishte 6 djem). Në fundin e luftës së Trojës, Helenus luftoi kundër vëllait të tij Deifobus (pasi u vra dhe Paridi) për tu martuar me Helenën, por Helena I u dhurua Deifobit. Heleni i mërzhitur, iku në malin Ida por u zu rob nga Uliksi. Pas luftës së Trojës, Neoptolemi djali i Akilit, mori për robinjë dhe pastaj u martua me kunatën e Helenit dhe gruan e Hektorit- Andromakën (bwri tre djem njw nga ata Mollosi qw themeloi mbretwrinw e Mollosisw qw kishte nw kufi kaonwt dhe thesalinw), po kështu mori me vehte dhe Helenin. Të tre këta jetuan në Molosi të Epirit, por Neoptolemi para se të linte Epirin, i lejoi ata të themelojnë qytetin Buthros (Butrinti i sotëm). Neoptolemi u vra nga Oresti djali I Agamemnonit për shkak të Hermionit, bijës së Menelaut dhe të Helenës.

(Myth&Legends të shkruar nga Thomas Bullfinch, 1993).

Enea në udhëtimin e tij homerik (sipas Virgjilit) mbrriti në bregdetin e Butrintit dhe u habit kur takoi kushëririn e tij Helenus-in dhe gruan e kushëririn të tij Hektor Andromakën. Ata e furnizuan me ushqime dhe Heleni profetizoi (sepse këtë dhunti e kishte së bashku me motrën e tij binjake Kasandrën) që Enea do të bëhej babai I një kombi të madh (kujton që Enea u martua me Lavinjën nga ku lindi kombi romak dhe Roma). (Virgil in Aeneid Book III).

Më vonë Helenus-i u martua me motrën e Neoptolemit. Deidamia, për të mbajtur mbretërinë e Mollosisë dhe të Epirit.

Si përfundim, kështu lindi dhe u forcua gradualisht populli Helen që sipas mitologjisë por dhe historiografisë ishte tërësisht një fis tërësisht iliro-pellazgik, dhe jo ndryshe nga ta.

Kjo është dhe arsyeja që ata flisnin të njëjtën gjuhë sepse gjatë luftës por dhe gjatë robërisë nuk kishin nevojë për përkthyes, por dhe se kishin të njëjtat rite, doke e tradita.



*Helenus (i biri) dhe Priami (i jati)*

Ndoshta është më e arësyeshme që në të ardhmen historianët grekë dhe shqiptarë të hulumtojnë për lashtësinë e iliro-pellazgëve së bashku sesa duke kundërshtuar njëri tjetërin; megjithatë historia e vërtetë është ajo që thotë mitologjia e cila ka në thelbin e saj të vërteta të cilat historiografia greke, shqiptare dhe e huaj sot po i kupton më mirë qoftë me ndihmën e gjuhës shqipe, qoftë me tejkalimin e urrejtjes së disa individëve nga të dy anët të cilët s’bëjnë gjë tjetër përveçse do të vonojnë por jo do të pengojnë zbulimin e të vërtetave historike që fshihen në muzgun e të kaluarës së përbashkët të të dy kombeve tona.

### **Literatura**

- Robert d'Angely 'Enigma' -vëllimi i I, Pellazgët, 1990, f. 5-140).
- Myth&Legends të shkruar nga Thomas Bullfinch, 1993).
- Virgil in Aeneid Book III).
- Testamenti i Vjetër- Libri i Zanafillës-'Pasardhësit e bijve të Noah-ut-10-d-25. F.15).
- pjesë shkrimi të botuar te gazeta Koha Jonë më 31 mars dhe 1 prill 2005).
- Marrë nga Forummi shqiptar: Arcas 10/11/2005):  
(<http://ëëë.ansëers.com/topic/greek-language>, <http://ëëë.communicaid.com/language-courses/greek/index.php>,  
<http://ëëë.toplanguagecommunity.com/greek-portal/>, <http://ëëë.eslbase.com/language-exchange/greek>,  
[http://simple.ëikipedia.org/ëiki/Greek\\_language](http://simple.ëikipedia.org/ëiki/Greek_language), <http://ëëë.studyabroad.com/lom/greek.html>  
[http://ëapedia.mobi/en/Greek\\_language](http://ëapedia.mobi/en/Greek_language)).
- Hofman (J. B. Hofmann, (EËG), 1950).
- Smith, Anthony D. (1999). *Myths and memories of the nation*. Oxford University Press. p. 21. ISBN 0-19-829534-0. "It emphasizes the role of myths, memories and symbols of ethnic chosenness, trauma, and the 'golden age' of



saints, sages, and heroes in the rise of modern nationalism among the Jews, Armenians, and Greeks—the archetypal diaspora people”).

-Argyris Eftaliotis një histori të Greqisë më 1901 me titullin ‘Historia e Romanëve’

-Neritan Ceka, "Iliret", T 2000, f.33).

-Mathieu Aref, "Shqipëria, odiseja e pabesueshme e një populli parahelen").

- Markezines, "*Political History of Modern Greece*", book A, pp.208, Athens.).

-Formumi Shqiptar- Pellazgët, 2005).

-"The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present", Edëen E. Jacques).

-Prof. Nezir Myrta (Drillon Gega) albanologu Nezir.Myrta@shqiperia.com)

## Studiues

Pirro Prifti (Prof.As.Dr.)